


7. Cili komponim fitohet gjatë reaksionit të bezaldehidës me LiAlH_4 ?

- A. $\text{C}_6\text{H}_5\text{OH}$. B. $\text{C}_6\text{H}_5\text{CH}_2\text{OH}$. C. $\text{C}_6\text{H}_5\text{COCH}_3$. D. $\text{C}_6\text{H}_5\text{COOH}$.


8. Kripërat e acidit me formulën e dhënë më poshtë



emërtohen:

- A. citrate. B. laktate. C. sukcinatë. D. tartarate.

9. Mëposhtë është dhënë skema reaksionale:




P është komponim karbonil me formulë molekulare $\text{C}_4\text{H}_8\text{O}$ dhe nuk reagon me tretësirë amoniakale të nitratis të argjendit. Cili prej pohimeve të dhëna mëposhtë është i saktë për komponimet e shënuara me shenja të përgjithshme prej P deri Z në skemën reaksionale?

- I. Emri i komponimit P është butanal.
 II. Gjatë adicioneve të HCN nga ana e komponimit karbonil, fitohet komponim me formulë strukturale racionale: $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{C}(\text{OH})(\text{CN})\text{CH}_3$.
 III. Komponimi i shënuar me R në skemën reaksionale reduktohet deri në komponimin S, emri i të cilit është: 2-metilbutan-1,2-diol.
 IV. Formula strukturale racionale e komponimit të shënuar me Z është $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{CCl}_2\text{CH}_3$.

- A. Vetëm I dhe II. B. Vetëm I, II dhe III. C. Vetëm II dhe III. D. Vetëm II, III dhe IV.

10. Cila është formula strukturale racionale e produktit Q, që fitohet gjatë reaksioneve të pasqyruara në skemën reaksionale që është dhënë mëposhtë:



- A. $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOC}_6\text{H}_5$. B. $\text{C}_6\text{H}_5\text{COOCH}_2\text{CH}_3$.
 C. $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COC}_6\text{H}_5$. D. $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOCOC}_6\text{H}_5$.

11. Cila prej substancave të dhëna mëposhtë ka mundësi të formojë lidhje hidrogjenore me molekulat e ujit?

- A. N_2 . B. $\text{C}_6\text{H}_5\text{CH}_2\text{CH}_3$. C. $\text{CH}\equiv\text{CH}$. D. $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{CONH}_2$.

12. Cili komponim fitohet me adicioneve të acetaldhidës te acetoni?








- A. $(\text{CH}_3)_2\text{C}(\text{OH})\text{CH}_2\text{CHO}$. B. $\text{CH}_3\text{CH}(\text{OH})\text{CH}_2\text{CHO}$.
 C. $(\text{CH}_3)_2\text{C}(\text{OH})\text{CH}_2\text{COCH}_3$. D. $\text{CH}_3\text{COCH}_2\text{CHO}$.



13. Cili pohim është i saktë për butan-1-olin?
A. Në reaksion me acidin pentanoik formohet $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{CH}_2\text{COO}(\text{CH}_2)_4\text{CH}_3$.
B. Reagon me kaliumin me çrast prej reaksionit lirohet gaz.
C. Oksidohet me $\text{K}_2\text{Cr}_2\text{O}_7$ në prani të acidit sulfurik deri në acid valerik.
D. Fitohet me anë të reaksionit të hidratimit të but-1-enit.
14. Cili alkool lehtësisht oksidohet deri në keton?
A. 1-etilciklopentanoli. B. 3-etilpentan-3-ol.
C. 3-metilbutan-2-ol. D. alkooli izobutilik.
15. Numri i atomeve të karbonit me hibridizim sp^3 në molekulën e komponimit me emër: 4-etenilciklopent-1-en, është:
A. 2. B. 3. C. 4. D. 5.
16. Acidi citrik është acid i dobët organik. Emri i tij sistematik është: acidi 2-hidroksipropan-1,2,3-trikarboksilik.
A. Shënoni formulën strukturale racionale e acidit citrik.
B. Acidi citrik formon kripëra citrate. Shëno formulën e kripës: citrat natriumi.
B. Kalkuloni sa është vëllimi i tretësirës së hidroksidit të natriumit që nevojitet për reaksion, në qoftë se në dispozicion keni tretësirë të hidroksidit të natriumit me pjesëmarrjen e masës së substancës së tretur 15%, ndërsa dendësia e kësaj tretësire është 1.135 g/cm^3 , që në fund të fitohen si produkt 1.29 g citrat natriumi.

8 pikë

Види го решението во македонската верзија од тестот.
See the Macedonian version for the correct answers.

17. Shënoni në tabelë formulat strukturale të komponimeve të cilat janë shënuar me shkronjat e përgjithshme A, C, E, F, L dhe M, si dhe emrat e komponimeve të shënuara me shkronjat B, D, G, H, I, J dhe K në reaksionet vijuese:



	A	B	C
		Ciklopenten	$\text{CH}_3\text{CH}_2\text{CH}_2\text{COOH}$
D Izopropil butanoat/butirat	E $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOH}$	F $\text{CH}_3\text{CH}_2\text{COOCH}_2\text{CH}_3$	
G tert-butylbenzene	H <i>o</i> -nitro- <i>tert</i> -butilbenzen	I <i>p</i> -nitro- <i>tert</i> -butilbenzen	J 1,2-dibromo-1-feniletan
K Anhidridi i acidit acetik	L 	M 